



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 8 shtator 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Cerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Puhie Demaku, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Margarita K. Ukelli – deputete, Sanije Berisha – OSBE, Kaltrina Ahmeti – GLPS, Mergime Kajtazi dhe Fjolla Uka – KDI, Bashmir Xhemaj – Këshilltar, Gurjeta Zeka – LVV dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me 29 korrik 2015;
3. Diskutim për agjendën e Komisionit gjatë sesionit vjeshtor;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më dt. 29 korrik 2015

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur, më dt. 29 korrik 2015.

3. Diskutim për agjendën e Komisionit gjatë sesionit vjeshtor;

Enver Hoxhaj: fillimisht njoftoi se janë edhe disa çështje për të cilat duhet të diskutohet gjatë këtij sesioni e po ashtu theksoi krizën e refugjatëve, e cila e ka përfshirë Ballkanin, temë kjo e cila do të duhej të merrej në konsideratë nga Komisioni.

Hoxhaj tha se janë arrit disa marrëveshje në Bruksel, dhe se për këto marrëveshje duhet të kemi një gjuhë të përbashkët që Bashkimi Evropian ta mbështesë Kosovën në mënyre reciproke, meqë deri më tani nuk e ka trajtuar drejtë Kosovën.

Me kërkesë të Komisionit tha se, është sjell një raport i plotësuar nga z. Murat Meha, lidhur me demarkacionin e kufirit me Malin e Zi.

Ramush Haradinaj: tha se raporti i z. Murat Meha nuk duhet të shpërndahet, sepse ai është në gabim, dhe se kemi bërë apel disa herë që kjo marrëveshje të mos nënshkruhet. Sa i përket çështjes së refugjatëve tha se, nuk duhet të diskutojmë për këtë çështje, ngase më shumë se 100 mijë shqiptar të Kosovës kanë ikë nga ky vend.

Lidhur me marrëveshjen e Brukselit për kufirin tha se, Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa kanë gabuar me nënshkrimin e saj. Më tej shtoi se si Komision i Punëve të Jashtme duhet të kërkojmë që marrëveshjet e nënshkruar të vijnë në Kuvend, për diskutim dhe ratifikim.

z. Haradinaj tha se me këtë marrëveshje Kosova humb dhjetëra, mijëra hektarë. Na është thënë se po që se nuk e bëmë demarkacionin e kufirit nuk do të ketë liberalizim të vizave, gjë që nuk është ashtu.

Enver Hoxhaj: duke iu referuar z. Haradinaj tha se Kuvendi i Kosovës e ka miratuar një Rezolutë të propozuar nga Grupi Parlamentar i AAK-së, me mbështetjen e të gjitha partive politike, e cila e fton për raportim Komisionin Shtetëror për Shënjimin e Kufirit, në Komisionin për Punë të Jashtme.

Po ashtu tha se sipas Rezolutës të miratuar në Kuvend, ne si Komision kemi organizuar një dëgjim publik për këtë çështje. Z. Murat Meha e ka sjell një raport sepse ka qenë kërkesë e Komisionit dhe unë kërkoj që ky Komision të ia përcjell Kryesisë së Kuvendit raportin ashtu siç është e paraparë me rezolutë.

Zafir Berisha: tha se pajtohet me z. Haradinaj, dhe se ne nuk mund të diskutojmë për një raport, i cili është shpërndarë gjatë mbledhjes ngase është dashur të futet pikë e rendit të ditës për shqyrtim.

Lidhur me çështjen e refugjatëve tha se është shqetësuese përjetimi i ngjarjeve që po ndodhin me refugjatët sirianë, por ne kemi refugjatë të Kosovës në vendet e BE-së dhe nuk mund ta kemi atë komoditet që të bisedojmë për ata, kur vetë qytetarët e këtij vendi janë refugjatë.

Sa i përket marrëveshjeve të arritura në Bruksel tha se në seancë do t'i themi qëndrimet tona dhe shtoi se ky Komision me Rregullore të Punës e ka të paraparë se duhet ta shikojë planin e politikës së jashtme të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Z. Berisha tha se do të ishte mirë që këto çështje që u ngritën të jenë pika të veçanta të rendit të ditës, të kemi material dhe të zhvillojmë diskutimet, në Komision.

Enver Hoxhaj: tha se nuk kam dashtë të bëjë një rend të ditës për këtë mbledhje në rrafshin shumë përmbytësor, por t'i ngris disa çështje që mund t'i diskutojmë edhe gjatë javës.

Sa i përket raportit të z. Meha tha se nuk kam kërkuar që të miratohet në këtë takim, por vetëm të shpërndahet, unë jam i obliguar t'ua shpërndaj raportin, por po ashtu jam i obliguar të dërgoj një kopje Kryesisë së Kuvendit para se të ndodh debati për miratimin e marrëveshjes.

Hoxhaj njoftoi për temat që presin që shqyrtohen në Komision, siç janë propozimet e MPJ-së për kandidatët për ambasadorë, ftesë për takim në Beograd, njoftimin për anëtarësimin në një organizatë nga deputeti Muhamet Mustafa, shkresat e dërguara për anëtarësim në disa organizata, materialet për formimin e grupeve të miqësisë dhe disa ftesa nga komisione të ndryshme.

Puhie Demaku: shprehu pajtueshmërinë me z. Haradinaj dhe z. Berisha se është dashur të veprohet sipas rendit të ditës.

Lidhur me marrëveshjet e Brukselit tha se deputetët po vendosen para aktit të kryer, marrëveshja tani është e nënshkruar. Për raportin e z. Meha tha se duhet ta kemi kohen e nevojshme, që t'i marrim qëndrimet tona para se të dërgohet tek Kryesia e Kuvendit.

Sa i përket listës së propozuar për ambasadorë, tha se në Qeveri është miratuar ligji i ri për shërbimin e jashtëm dhe duhet të vendosim se a e diskutojmë së pari ligjin apo vazhdojmë me dëgjimin e ambasadorëve me procedurë të rregullt sipas ligjit të vjetër.

Ngriti shqetësimin për dekretimin e ambasadorëve, duke cekur se Komisioni ka dërguar një raport, i cili ka treguar se ka pasur shkelje procedurale dhe kërkoi që Komisioni të diskutoj për këto dekretime.

Ismet Beqiri: lidhur me propozimet për ambasadorë tha se deri sa të miratohet ligji i ri në Kuvend duhet të veprojmë sipas ligjit të vjetër.

Sa i përket raportit të z. Meha tha se ne e kemi mbajtur një mbledhje dhe raportin me shkrim mund të ia përcjellim Kryesisë së Kuvendit.

Për marrëveshjet e Brukselit tha se Kryeministri do ta informojë Kuvendin, ku secili deputet mund të jep mendimin e tij dhe se do të ketë edhe marrëveshje në mes dy shteteve tona për shfrytëzimin e asaj hapësire që është shfrytëzuar deri më tani.

Elmi Reçica: shprehu shqetësimin e lidhur me zhvillimet e mbledhjeve të fundit të Komisionit dhe propozoj që të diskutohen në një nga mbledhjet e radhës raportet në Komision, para se të diskutohen temat e përmendura.

Krizën e refugjatëve tha se nuk është në rregull nëse e gjithë bota e diskuton e ne mos ta diskutojmë duke e pas parasysh që është çështje shqetësuese dhe është prezente edhe tek ne.

Sa i përket çështjes së kufirit dhe marrëveshjeve të arritura në Bruksel tha se janë shqetësim dhe se janë duke u diskutuar dhe se këto çështje duhet të shikohen nga gjitha këndet dhe pastaj të merret vendimi.

Kryetari i Komisionit Shtetëror tha se ka përgjegjësi penale për veprimet e tij, mirëpo duhet bërë dallimi kur një pronë ka qenë brenda shtetit të Kosovës, dhe kur tatimi është paguar në Rozhajë. Këto marrëveshje tha se, duhet të ratifikohen në Kuvend, ky është edhe qëndrim i Komisionit.

Cerim Bajrami: pajtohet me z. Reçica, dhe shtoi se si Komision shumë i rëndësishëm nuk është dashtë të lejojmë të krijohet një atmosferë e tillë. Theksoi se në Komision duhet të ekzistoj një atmosferë kolegjiale. Ne duhet të tregojmë humanizmin tonë, nëse refugjatët dëshirojnë të vijnë në Kosovë.

Sa i përket nënshkrimit të marrëveshjeve tha se, edhe po që se opozita do të ishte në pushtet do t'i nënshkruante marrëveshjet e tilla, duke cekur se çështja e kufirit është çështje e ndjeshme dhe se asnjë nga deputetët nuk do ta ngriste dorën në Kuvend nëse një marrëveshje do ta dëmtonte Kosovën.

Enver Hoxhaj: propozoj që Komisioni të mbajë mbledhje me 9 shtator 2015, duke filluar nga ora 10:00 ku do të dëgjoj kandidatët e propozuar për ambasadorë dhe të dëgjohen nga dy kandidatë në ditë. Përveç çështjes së ambasadorëve, tha se duhet ta kemi edhe një takim për anëtarësimet tona në organizata dhe një takim për grupet e miqësisë.

Kryetari i ftoj anëtarët e Komisionit të propozojnë tema shtesë që të fillojmë të plotësojmë agjendën për sesionin vjeshtor.

Puhie Demaku: shprehu shqetësimin se ka kaluar një sesion i tërë pranveror pa raportimin e Ministrit të Jashtëm, pa e pasur as strategjinë dhe planin e punës së Ministrisë së Jashtme në mënyrë që të ekzistojë një koordinim në mes të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Ministrisë së Jashtme. Propozoi që të rishqyrtohet data e zhvillimit të vizitës në Bruksel, e paraparë të mbahet në tetor për shkak të publikimi të Raportit të progresit.

Për agjendën e Komisionit gjatë sesionit vjeshtor ceku zhvillimin e një vizite në Shqipëri, dhe shqyrtimin e Ligjit për Shërbimin e Jashtëm.

Znj. Demaku po ashtu propozoj që të kërkohet një listë nga MPJ me emrat e ambasadorëve, të cilët janë në detyrë dhe kur janë emëruar që ta kemi më të qartë se cilat vende duhet trajtuar më me urgjencë.

Zafir Berisha: Propozoj që të hiqet nga agjenda raportimi i Ministrit të Jashtëm dhe të atij për Integritet Evropian, për shkak të mosgatishmërisë së tyre të raportojnë në Komision edhe përkundër ftesave të bëra për raportim.

Çështjet të cilat Kryetari i diskutoi, tha se është mirë me i propozua në plotësimin dhe ndryshimin e agjendës së punës së Komisionit, për muajt në vijim.

Blerta Deliu-Kodra: shprehu shqetësimin e saj për gjuhën e përdorur gjatë dy mbledhjeve të fundit të Komisionit.

Propozoj që të ftohet në raportim Ministri i Integritetit Evropian meqë jemi para publikimit të Raportit të progresit për Kosovën, të njoftohemi për sfidat dhe të arriturat që i kanë bërë institucionet e vendit, lidhur me procesin e integritetit dhe liberalizimit të vizave.

Ismet Beqiri: shprehu mendimin që të vazhdojmë me dëgjimet e kandidatëve të propozuar për ambasadorë. Sa i përket asaj që tha deputetja Demaku, tha se pajtohem plotësisht që të kemi një listë, por kjo nuk duhet të paraqet pengesë që të mos e vazhdojmë punën.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni fton në dëgjim kandidatët e propozuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, më 9 dhe 10 shtator 2015.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Enver Hoxhaj